



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Muhamet Kurtishaj	10.04.2026	16.04.2026	2026/0229

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 10.04.2026, OE “Besiana SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2026/0229, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “Kadiu”- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “FURNIZIM ME VAJRA PËR AUTOMJETE TE PK-se” me nr. të prokurimit: "214/30400-25-9404-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë hapur, furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 300.000,00 €. Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

AK, me rastin e publikimit të dokumentit Njoftimi mbi Vendimin e AK dt. 18.03.2026 dhe Letrën standarde për Tenderuesin e Eliminuar, ka vepruar në kundërshtim me LPP-së:

- Neni, 1, 6, 7, 59 paragrafi 2 dhe 4, 72 dhe

- Rregulloren për Prokurim Publik neni 37 paragrafi 37.6, 38 paragrafi 38.3, 38.4 dhe 38.5, Neni 40 paragrafi 40.2, 40.6, 40.7 dhe 40.12, neni 45 paragrafi 45.19, 45.20 dhe 45.21

AK me dt. 18.03.2026, përmes postes elektronike të E-Prokurimit ka dërguar dokumentin “ B58 NJOFTIM MBI VENDIMIN E AK dhe Letrat Standarde”, ku njoftonte se oferta e OE BESIANA SHPK, është eliminuar me arsyetimin se;

Në DT Pjesa B artikulli 6 është kërkuar: Vaj Motori Bus-Temsa-OtoyolSAE 10W-40 ACEA E9,API CJ-4,MAN M 3477/MB 228.5 - Paketimi:5 deri 20 Litër. OE e ka sjelle paketimin 4L;

-

OE gjithashtu ka dështuar tek Poz. 3: - Ne mostrën e ofruar mungon dëshmia mbi ISO 22241-1. OE ka ofruar vetëm ISO 22241 ndërsa ne katalog ka dëshmi që është ISO 22241-1. Bazuar ne nenin 59 dhe 72 kemi pas mundësi ta sqarojmë me prodhuesin por nuk e kemi sqaruar pasi që nuk do të sjellte rezultat. OE për arsyet me larte është i papërgjegjshme dhe oferta i refuzohet

Po ashtu me keto dokumente AK njoftonte se OE KADIU shpk, Prishtinë e ka propozuar për shpërblim me kontratë.

Ekspertët tanë kanë analizuar të gjitha dokumentet e tenderit, vendimet e AK si dhe ofertën e OE KADIU shpk, dhe kanë gjetur se AK me rastin e vlerësimit të ofertave nuk ka vepruar sipas kritereve të përcaktuara në DT, kërkesave të LPP-se dhe Rregullores për Prokurim 01/2022 plotësuar me rregulloren 01/2024 (tani e tutje si RrPP), për keto arsye;

1.

Sa i përket vërejtjes së par të AK, për ofertën tone që lidhet me, po citoj; "artikulli 6 është kërkuar: Vaj Motori Bus-Temsa-Otoyol SAE 10W-40, ACEA E9, API CJ-4, MAN M 3477/MB 228.5 - Paketimi: 5 deri 20 Litër. OE e ka sjelle paketimin 4L", ku AK e refuzon ofertën tone për arsye se ne kemi dorëzuar si mostër të këtij artikulli, një mostër me paketim prej 4 litrash, ne konsiderojmë se me këtë veprim AK se pari ka vepruar në kundërshtim me DT pjesa e FDT-se neni 9.1&9.2 pika (a) e pastaj edhe me RrPP neni 37 paragrafi 37.6.

Sepse, AK në asnjë pjesë të DT nuk ka përcaktuar madhësinë e mostrës, por ka kërkuar vetëm që të dorëzohet një mostër për secilin artikull, dhe sipas kërkesës së DT pjesa e FDT-se neni 9.1&9.2 pika (a) kërkohet

"Operatori Ekonomik duhet të dorëzojë nga një mostër për çdo artikull, ku secila mostër duhet të ketë etiketën me përshkrime të specifikacioneve teknike të kërkuara, mostra duhet të jetë origjinal dhe jo e improvizuar dhe ato duhet të dorëzohen më së largu deri në ditën e hapjes para orës 14:00", pra në kërkesën e DT nuk përcaktohet madhësia e mostër por vetëm kërkesa për një mostër dhe përshkrimi. Dhe nëse si OE ofertues kemi dorëzuar një paketim prej 4 litrash si mostër të këtij produkti, së bashku me dokumentet mbështetëse të dërguara nga prodhuesi, si certifikatën e kualitetit, deklaratën e prodhuesit dhe deklaratën e OE, me të cilat kemi siguruar AK se mallrat e ofruar do të jenë se pari sipas kualitetit të kërkuar nga AK në Ankesin-1, dhe se dyti, nëse në shpallimi fitues edhe liferimet do të jenë sipas paketimeve të kërkuara nga AK dhe kualitetit të përcaktuar në DT dhe Aneksin-1. Dhe mostra e dorëzuar nga ne si dëshmi nuk e determinon e as nuk e nënkupton madhësinë e paketimeve të liferimeve dhe madhësinë e tyre, por vetëm përmbush kërkesën e DT-se dhe AK për mostër.

Po ashtu nëse i referohemi edhe kërkesave të RrPP neni 37 paragrafi 37.6, përcaktohet qartë për çfarë arsye kërkohet mostra, po citoj paragrafin 376 të nenit 37, si;

"37.6 Mostrat e kërkuara janë pjesë e tenderëve, dhe ato janë pjesë të testit teknik të nevojshëm

për vlerësimin e secilit tender. Si pasojë, testi bëhet pjesë e procesit të vlerësimit, dhe rrjedhimisht kontraktin e përzgjedhur. Mostrat e kompanisë se shpërblyer me kontratë duhet të ruhen nga autoriteti kontraktues për gjatë tërë kohëzgjatjes së kontratës. Për sa i përket tenderuesve jo të suksesshëm, mostrat e tyre mund të kthehen tek ofertuesit (me kërkesë specifike) me kusht që ato ende ekzistojnë fizikisht (në kuptimin që testi nuk ka shkatërruar mostrën) dhe afati për të parashtruar anekse kundër vendimit të marrë nga autoriteti kontraktues për shpërbllim të kontratës ka skaduar”.

Prandaj, mostra e dorëzuar nga ne është plotësisht siaps kërkesave të DT-se dhe kërkesave të LPP-se dhe RrPP-se, dhe si e tillë duhet të vlerësohet edhe nga AK.

2.Sa i përket vërejtjes së dytë të AK, që lidhet me artikullin e 3, po citoj, se; “Poz. 3: - Ne mostrën e ofruar mungon dëshmia mbi ISO 22241-1. OE ka ofruar vetëm ISO 22241 ndërsa ne katalog ka dëshmi që është ISO 22241-1. Bazuar ne nenin 59 dhe 72 kemi pas mundësi ta sqarojmë me prodhuesin por nuk e kemi sqaruar pasi që nuk do të sjell të rezultat”, me të cilin arsyetim AK e refuzon ofertën tone për arsye se ne mostrën e dorëzuar nga ne për këtë artikull, ne përshkrimin e përmbajtjes mungon përshkrimi “ISO-22241-1”, ne konsiderojmë se me këtë veprim AK se pari ka vepruar në kundërshtim me DT pjesa e FDT-se neni 9.1&9.2 pika (a, b dhe c) si dhe Aneksin-1, pozicioni 3, si dhe LPP-e nenin 59 paragrafi 2 dhe 4 si dhe me RrPP neni 37 paragrafi 37.6, neni 38 paragrafi 38.3, 38.4 dhe 38.5 si dhe Neni 40 paragrafi 40.1, 40.6, 40.7, neni 45 paragrafi 45.18, 45.19, 45.20 dhe 45.21.

Sepse, AK ne DT pjesa e FDT neni 9.1&9.2 pika (a, b dhe c) ka kërkuar që cdo ofertues se bashku me ofertën e tij të dorëzojë, mostrën, Certifikatën ISO 9001 të prodhuesit, dhe aprovimet nga prodhuesi për cdo artikull të ofruar, ndërsa ne Aneksin -1 ka përcaktuar kriteret teknike për cdo artikull që ka kërkuar, e që cdo ofertues duhet të plotësojë për tu konsideruar i përgjegjshëm.

Sa i përket artikullit në Pozicionin-3, pjesa Performancat, AK nuk ka përcaktuar asnjë lloj kriteri apo specifikimi teknik të produktit që kërkon, thjesht ka përshkruar vetëm “ISO-22241-1” (pa dhënë asnjë sqarime tjetër).

Ne si OE ofertues me çmimin me të lirë, së bashku me ofertën tone kemi dorëzuar edhe këto dokumente;

o

Dokumentin-1. Deklaratat – mbi afati në liferimit ++, ku përfshihet edhe Deklarata mbi “Përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave”, përmes së cilës ne i kemi garantuar AK se mallrat e liferuar nëse ne shpallemi fitues do të jenë plotësisht siaps kërkesave të DT-se dhe kërkesave teknike të Aneksit-1;

o

Dokumentin-4. Autorizimi nga Prodhuesi, ku prodhuesi i vajrave LPC Greqi, e garanton AK se “Përmes këtij dokumenti, ne deklarojmë se Korporata e Lubrifikantëve dhe Naftës (LPC) do të prodhojë produktet me specifikimet e kërkuara nga Policia e Kosovës, për numrin e prokurimit: 214/30400-25-9404-1-1-1, me titullin e aktivitetit të prokurimit: FURNIZIM ME VAJRA PËR AUTOMJETE TË PK-së, me një kohëzgjatje prej 36 muajsh nga data e fillimit të kontratës., dhe

po ashtu e autorizon BESIAN SHPK, si distributor të vetëm të autorizuar për furnizim me keto vajra për AK.

o Dokumentin-5. ISO Certifikatat 9001/2015, ku ne kem dorëzuar certifikimet ISO të prodhuesit, të cilat i plotësojnë kërkesat e DT-se;

o Dokumenti-7. Katalogu dhe Aprovimet, ku ne faqe 6 dhe 7 për artikullin 3 kem dorëzuar Certifikatën e kualitetit të produktit të ofruar për këtë pozicion, ku janë të specifikuara shumë qartë të gjitha detajet dhe përmbajtja e produktit të ofruar nga ne, ku testimi është kryer siaps standardit ISO-22241 ndërsa secili përbërës i këtij artikulli është i testuar sipas metodave ISO-22241-1, dhe janë të specifikuara edhe përmbajtjet, dokument ky i lëshuar nga laboratorët e licencuar të prodhuesit, dhe ne mënyrë profesionale përshkruaj përmbajtjen dhe përbërjen e artikullit të ofruar nga ne, e cila përmbush plotësisht kërkesat e DT-se dhe të Aneksit-1.

Ndërsa sa i përket pretendimit të AK se ne mostrën e dorëzuar nga ne figuron vetëm dëshmia e testimit ISO-22241, dhe jo edhe përshkrimi ISO-22241-1, ne kem sqaruar se pari AK, por dëshirojmë të informojmë edhe OSHP-në se “ISO-22241” është standardi bazë i testimit që mbulon të gjitha aspektet e artikullit AdBlue për motorët me naftë, ndërsa “ISO-22241-1” është metodë testimi për përcaktimin dhe përmbajtjen e elementeve të caktuar të produktit e cila mund të jetë e ndryshme dhe siaps kërkesave të shfrytëzuesëve (provë letra nga prodhuesi dt. 23.03.2026).

Prandaj, nese i referohemi kërkesave të Aneksit-1 të DT, ne vërtetojmë se AK nuk ka përcaktuar as një kriter të artikullit të Pozicionit-3 AdBlue, qe ky artikull duhet të përmbaj, por aty është cekur vetëm “AD-BLUE ISO-22241-1”, dhe sipas sqarimeve edhe të prodhuesit kërkesa “ISO-22241-1” nuk paraqet as një lloj përcaktimi të specifikimeve të produktit, por paraqet metoden e testimit të një elementi të produktit.

Prandaj, ne kem dorëzua një moster duke i bashkangjitur të gjitha dëshmitë dhe garancitë e prodhuesit, se artikulli i ofruar nga ne është i testuar sipas standardit ISO-22241, dhe se nga testimi i këtij produkti rezultojnë përmbajtja e tij ashtu si është përshkruar ne certifikatën e kualitetet, ku cdo materieje përbërëse është testuar sipas testimit ISO-22241-1 dhe janë precizuar edhe përmbajtja për secilin prej tyre.

Duke vlerësuar produktin e ofruar deh certifikatën e kualitetit, ju vërtetoni, se ne i kem ofruar AK dëshmi të mjaftueshme dhe garanci të plota mbi kualitetin dhe testimin e produktit të ofruar i cili është plotësisht sipas kërkesave të DT dhe Aneskti-1, si dhe garanci të plota si nese ne shpallemi fitues, jo vetëm ky artikull por të gjithë artikujt e kerkuar në këtë tender do të prodhohen sipas kërkesave të DT dhe Aneksit -1.

Po ashtu nese i referohemi kërkesave të RrPP-se neni 37 paragrafi 37.6, ku kërkohet “ Mostrat e kërkuara janë pjesë e tenderëve, dhe ato janë pjesë të testit teknik të nevojshëm për vlerësimin e secilit tender. Si pasojë, testi bëhet pjesë e procesit të vlerësimit”, ne vërtetojmë se mostrat e dorëzuar nga OE ofertues kan efektin e “testimit teknik” për të verifikuar përmbajtjen e deklaruar nga prodhuesi dhe ofertuesi, dhe nga dëshmitë e vlerësimit të dorëzuar nga AK, ne nuk kem pranuar as një dëshmi qe vërteton se AK ka kryer teste të mostrës se ofruar nga ne dhe qe testimi i tille nuk ka rezultuar sipas certifikatës se ofruar nga ne.

Duke ju referuar ofertës tonë dhe dokumenteve të ofruara si dëshmi për ketë artikull, si dhe kërkesës se DT Ankesi-1 ku thuhet “Lejohet me cilësi më të lartë duke ju referuar specifikave të

kërkuara në dosje të projektit" ne konsiderojmë se oferta jone është plotësisht e përgjegjshme dhe i përmbush të gjitha kërkesat te DT-se dhe Aneksit-1, duke i ofruar AK një produkt me cilësi shumë me të lart se kërkesat e Aneksit-1, prandaj si e tille edhe duhet të pranohet nga AK.

Duke par lëshimet e AK me rastin e vlerësimit të ofertës tone ne konsiderojmë se;

AK duke përdorur si arsyetim për eliminimin e ofertës tone "madhësinë e paketimit të mostrës tone për Artikullin nr. 6", se pari ka vepruar ne kundërshtim me DT-se pjesa e FDT neni 9.1&9.2 pika (a) dhe se dyti ne kundërshtim me LPP neni 59 paragrafi 59.4 dhe RrPP-e neni 37 paragrafi 37.6, neni 38 paragrafi 38.3, 38.4 dhe 38.5, neni 40, paragrafi 40.2, 40.6, 40.7 dhe 45 paragrafi 40.19, 40.20 dhe 40.21;

- AK duke përdorur si arsyetim për eliminimin e ofertës tone "përshkrimin e fletës ne mostrën e dorëzuar për artikullin-3" se pari ka vepruar ne kundërshtim me DT-se pjesa e FDT neni 9.1&9.2 pika (a, b dhe c) dhe se dyti ne kundërshtim me LPP neni 59 paragrafi 59.2 dhe 59.4 dhe RrPP-e neni 37

Page 5 of 7

paragrafi 37.6, neni 38 paragrafi 38.3, 38.4 dhe 38.5, neni 40, paragrafi 40.2, 40.6, 40.7 dhe 45 paragrafi 40.19, 40.20 dhe 40.21;

Po ashtu AK me vendimin për anulimin e tërësishëm të ofertes tone si oferta me çmimin me të lirë për këtë tender ka vepruar edhe ne kundërshtim me DT-e neni 31.1, LPP-e neni 1, 6 dhe 7.

Sa i përket OE të propozuar për shpërblim me kontratë, KADIU shpk, ekspertët tanë gjate analizimit të ofertës se këtij OE ka gjetur këto mangësi qe nuk përputhen me DT dhe LPP-ne, sepse;

OE KADIU shpk, ne ofertën e tij ka ofruar si dëshmi Dokumentet me titull;

Për kërkesat e DT ne FDT neni 7.1&7.2 pika (e), ka ofruar dokumentin "Autorizimi nga Prodhuesi" ku ne kem vërtetuar se ky autorizim është lëshuar nga kompania UAB SCT LUBRICANTS, Lituani,

-

Ka ofruar edhe dokumentin "Deklarata nga Prodhuesi, ku ne kem vërtetuar se prodhuesi UAB SCT LUBRICANTS, Lituani, ka lëshuar një deklaratë mbi prodhimet e ofruara për artikujt 2, 4 dhe 6, te cilat janë nen markën "MANNOL";

-

Për kërkesat e DT ne FDT neni 9.1&9.2 pika (b), ka ofruar dokumentin Dokumenti "Certifikata ISO 9001-2015" ku ne kem vërtetuar se i përket prodhuesit UAB SCT LUBRICANTS, Lituani;

Për kërkesat e DT ne Aneskin-1, për artikujt 2, 3, 4 dhe 6, ka ofruar keto dokumentet si dëshmi për këta artikuj;

-

Katalogu Artikulli 2 – MANNOL Energy Formula OP 5W-30;

-

Katalogu Artikull 3 – Ad BlueR;

-

Katalogu Artikulli 4 – MANNOL Legend Ultra 0W-20;

-

Katalogu Artikulli 6 – MANNOL TS-7 UHPD 10W-40 Blue (2);

Mirëpo nese i analizojmë keto dëshmi, vërtetohet se të gjitha keto certifikata të kualitetit janë të lëshuara nga prodhuesi SCT Vertriebs GmbH, Gjermani, dhe jo nga autorizuesi dhe prodhuesi UAB SCT LUBRICANTS, Lituani.

Sipas sqarimeve të AK dhënë ne shkresën e dt. 30.03.2026 për refuzimin e kërkesës tone për rishqyrtim, kan deklaruar se;

-

“SCT-Vertriebs GmbH është kompani mëmë / pjese e te njëjtit grup me UAB SCT Lubricants dhe certifikata ISO mbulon edhe prodhimin ne Lituani. Certifikata është e lëshuar për SCT Lubricants UAB, Standardi: ISO 9001:2015 Scope (fusha e aplikimit): "Production and packing of engine, industrial and special purpose oils .."

Certifikata i përket drejtpërdrejt prodhuesit, Përfshin prodhimin e vajrave qe jane objekt i aktivitetit.

Dëshminë qe SCT-vertriebs GmbH-Gjermani dhe UAB SCT Lubricants Lituani është një kompani e gjeni edhe me poshtë nga kërkimet tona internet”

Të nderuar zyrtar të OSHP, ne si OE ankues dëshirojmë të ju qartësojmë se ne nuk e kem kontestuar lidhshmërinë mes ketyre dy kompanive, ne kem kontestuar faktin se vajrat e ofruara nga OE KADIU shpk prodhohen nga UAB SCT Lubricants Lituani ne shtetin e Lituanisë, ndërsa certifikata e kualitetit jan të prodhuesit SCT-Vertriebs GmbH-Gjermani me baze ne Gjermani. Sipas ketyre dëshmimeve, vërtetohet se OE KADIU shpk për produktet e prodhuara nga UAB SCT Lubricants Lituani ka sjell certifikatat e kualitetit të produkteve të prodhuesit SCT-Vertriebs GmbH-Gjermani, i cili është prodhues dhe prodhon vajra nen markën MANOL, dhe jo të prodhuesit nga i cili ka autorizimin dhe i cili i prodhon artikujt e ofruar ne tender, prandaj si të tilla keto certifikata nuk dëshmojnë kualitetin e produkteve të ofruara, dhe nuk është dashur të pranohen nga AK.

Po ashtu edhe ne dokumentet e dorëzuara nga AK, ne nuk kem pranuar as një dokument qe dëshmon se AK e ka sqaruar ketë dallim të dokumenteve me OE apo lëshuesin e autorizimit dhe certifikatave të kualitetit. Po ashtu ne nuk kem pranuar as një dokument qe dëshmon se AK e ka hulumtuar apo verifikuar ketë dallim mes ketyre dy dokumenteve “autorizimit të prodhuesit dhe lëshuesit te certifikatave të kualitetit”, për të sqaruar keto dallime.

Për veç kesaj vërejtje, po marr si shembull edhe certifikatën e kualitetit të ofruar nga OE KADIU për produktin nr.3 Ad Blue, e cila nuk përcakton as një karakteristike apo elementë përbërës të produktit.

Si dëshmi po e krahasoj certifikatën e ofruar nga OE KADIU me certifikatën e ofrua nga ne për këtë artikull, të cilin e ka refuzuar AK; si;



AdBlue®

3001

AdBlue® is a high-purity 32,5 % w/w urea solution which is used as an additional working fluid in diesel cars and trucks equipped with SCR technology (Selective Catalytic Reduction). The composition of AdBlue is specified in DIN 70070. The use of such systems optimises engine performance, reduces the emission of harmful particles in exhaust gas and complies with the environmental standards Euro 4, Euro 5 and Euro 6.

AdBlue® is a registered trademark of the German Association of the Automotive Industry (VDA Verband der Automobilindustrie e.V.).

Specifications

DIN 70070
ISO 22241-1
ISO 22241-2
ISO 22241-3

PACKAGING

AD3001-10	
AD3001-IBC	
AD3001-20	

DESCRIPTION

High cleanliness, ready-to-use solution of 32.5 percent urea in ultra-pure water. It is used as an additive in heavy duty diesel engines that are equipped with selective catalytic reduction (SCR) systems with the objective to reduce the NOx oxides.

APPLICATIONS

It is suitable for Euro IV and V (and in the future Euro VI) engines. It is NOT suitable for addition to the fuel tank. It is injected into tanks next to the fuel tank and is sprayed directly into the exhaust gases pipe. Its consumption is 3-4% (to cover Euro IV standards) and 5-7% (to cover Euro V standards) of the fuel consumption.

CHARACTERISTICS-BENEFITS

CHARACTERISTICS
High purity solution.
Low consumption (3-7%) depending on the desired degree of coverage of Euro requirements.
It is sprayed into the exhaust gases pipe.
In accordance with ISO 22241 "Diesel engines-NOx reduction agent AUS32".

PHYSICAL-CHEMICAL CHARACTERISTICS

AdBlue®	METHOD	
Density at 20°C, g/cm ³	ASTM D1298	1.09
Refractive index at 25°C	ISO 22241-1	1.383
Alkalinity (NH ₃), %wt.	ISO 22241-1	<0.2
Boiling point, °C	ISO 22241-1	103
Melting point, °C	ISO 22241-1	-11
pH (100g/L) at 20°C	ISO 22241-1	10
Urea content	ISO 22241-1	31.8-33.2
Diuria	ISO 22241-1	<0.3
Insolubles, mg/kg	ISO 22241-1	<20
Aldehyde, mg/kg	ISO 22241-1	<5
Phosphates	ISO 22241-1	<0.5
Calcium	ISO 22241-1	<0.5
Iron	ISO 22241-1	<0.5
Copper	ISO 22241-1	<0.2
Zinc	ISO 22241-1	<0.2
Chromium	ISO 22241-1	<0.2
Nickel	ISO 22241-1	<0.2
Aluminium	ISO 22241-1	<0.5
Magnesium	ISO 22241-1	<0.5
Sodium	ISO 22241-1	<0.5
Potassium	ISO 22241-1	<0.5
Appearance	Optical	Colorless liquid

The above mentioned characteristics represent mean values.

Për më shumë detaje referoju certifikatave ne ofertën tone deh oferte e OE KADIU shpk

Po ashtu nese ju referohemi kërkesave të DT ne Aneskin-1, për artikujt 1 dhe 5, shohim se OE

KADIU shpk ka ofruar keto dokumentet si dëshmi për këta artikuj;

-

Katalogu artikulli 1;

-

Katalogu artikulli 5;

Mirëpo nese i analizojmë keto dëshmi, vërtetohet se të dyja keto dokumente nuk kanë dëshmi se nga cili prodhues janë lëshuar, pra mungon autorësia e lëshuesit të këtyre dokumenteve.

Po ashtu ne nuk kemi pranuar asnjë dokument që dëshmon se AK e ka hulumtuar apo që ka kërkuar sqarime nga OE për këto dy dokumente, për të vërtetuar autorësinë e tyre si dhe prodhuesin.

Përveq tjerave, OSHP duhet të shqyrtoj edhe faktin tjerët për konflikt interesi sipas nenit 65 të LPP paragrafi 1, sepse shefi (menagjeri) i flotës së automjeteve në Policinë e Kosovës është Ramadan Sylja, i cili është edhe hartues dhe nënshkruar i specifikimeve teknike të artikujve për këtë tender, ndërsa djali i tij Taulant Sylja është menagjer në kompaninë KADIU shpk (fakt që z. T. Sylja e publikon edhe në faqen e tij në FCB <https://www.facebook.com/taulant.sylja/>).

Ne më dt. 06.04.2026 kemi kërkuar nga AK të na dorëzojë kërkesën e njësisë kërkues për tenderin si dhe DNPDF, mirëpo më dt. 07.04.2026 AK ka refuzuar kërkesën tonë, me arsyetimin se keto janë dokumente të brendshme.

Prandaj, AK duke propozuar për shpërblim me kontratë një OE të pa përgjegjshme, se pari ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e DT-së dhe Aneksit-1, së dyti me LPP neni 1 dhe 6, neni 59 paragrafi 2 dhe 4, dhe neni 72, si dhe në kundërshtim me RrPP-e neni 40 paragrafi 40.1, 40.2, 40.6 dhe 40.7 si dhe nenin 38 paragrafi 38.3, 38.4 dhe 38.5.

Prandaj, bazuar në të gjitha këto që u cekën më lartë në kërkojmë nga OSHP që të nxjerr;

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar Ankesa e OE BESIANA shpk;

ANULOHET, njoftimi dhe vendimi i AK-së i datës 18.03.2026 dhe eliminimi i ofertës së OE Besiana shpk, dhe lënda të kthehet në RI shqyrtim dhe gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni të plotë me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë, sqarimeve shtesë dhe konform dispozitave të Ligjit për Prokurim Publik, Rregullores nr. 01/2022 për Prokurim Publik dhe Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative .

KRITERET PËR VLERËSIM

Kriterr i vlersimit te ofrtave ka qene **Çmimi me i ulet.**

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Eshte rekomanduar per kontrate oferta e operatorit ekonomik "Kadiu" me çmimin e poentuar ne vlere te ofertes prej 20.44 €

Oferta e OE BESIANA SHPK, është eliminuar me arsyetimin se;

- Në DT Pjesa B artikulli 6 është kerkuar: Vaj Motori Bus-Temsa-OtoyolSAE 10W-40 ACEA E9,API CJ-4,MAN M 3477/MB 228.5 - Paketimi:5 deri 20 Litër. OE e ka sjelle paketimin 4L;

- OE gjithashtu ka dështuar tek Poz. 3: - Ne mostrën e ofruar mungon dëshmia mbi ISO 22241-1. OE ka ofruar vetëm ISO 22241 ndërsa ne katalog ka dëshmi qe është ISO 22241-1. Bazuar ne nenin 59 dhe 72 kemi pas mundësi ta sqarojmë me prodhuesin por nuk e kemi sqaruar pasi qe nuk do te sjellte rezultat. OE për arsyet me larte është i papërgjegjshme dhe oferta i refuzohet'

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

Nuk ka marre informacion shtese ekspert shqyrtues.

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

OE ankues eshte Pale me interes ne kete aktivitet te prokurimit.

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

Nuk ka pasur vendim te me parshem per kete aktivitet te prokurimit.

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

Nuk ka pasur devijim nga praktikat e mëparshme.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - Besiana SH.P.K.

Pergjigje ne pretendimin e pare

Operatori Ekonomik (OE) ne pretendimin e parë konteston vendimin e Autoritetit Kontraktues (AK) për eliminim, duke e konsideruar atë të pabazuar dhe në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së dhe Rregulloren e Prokurimit 01/2022 (neni 37.6). OE pretendon se eliminimi për shkak të paketimit të mostrës prej 4 litrash (për artikullin 6), ndërsa në specifikim kërkohej paketim 5-20 litra është i padrejtë sepse Dosja e Tenderit (DT), specifikisht FDT 9.1 & 9.2, kërkonte "një mostrë për secilin artikull" pa përcaktuar madhësinë/vëllimin specifik të vetë mostrës. Mostra shërben për verifikimin e cilësisë së substancës (vajit) dhe jo si dëshmi e kapacitetit logjistik të paketimit final. OE ankues ka dorëzuar dokumentacion mbështetës (Certifikata kualiteti, Deklarata e prodhuesit dhe deklaratën e tij për Origjinën e mallrave dhe prodhuesin përbushjen e specifikave teknike të mallrave Afatin e Garancionin dhe liferimit (Ambalazhit për vajra) që garanton se liferimet gjatë ekzekutimit të kontratës do të jenë në paketimet e kërkuara prej autoritetit kontraktues

Eksperti Shqyrtues pas analizimit të shkresave të lëndës, specifikimeve teknike në Dosjen e Tenderit dhe pretendimeve të palës ankuese, jep këtë mendim profesional. Në pikën 9.1 dhe 9.2 të FDT-së, AK ka kërkuar dorëzimin e mostrave për të vërtetuar përputhshmërinë teknike. Megjithatë, AK nuk ka specifikuar në mënyrë taksative që **vëllimi i mostrës** duhet të jetë identik me **vëllimin e paketimit për liferim**. Në praktikën e prokurimit, mostra është dëshmi fizike e cilësisë së produktit (në këtë rast vaji motorik SAE 10W-40, ACEA E9, etj.) dhe jo domosdoshmërisht dëshmi e formës së paketimit komercial që do të përdoret gjatë liferimit periodik.

Devijimi jo-material sipas Nenit 59 të LPP-së, respektivisht Neni 59, pika 4, përcakton se AK mund ta konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse ai përmban vetëm devijime të vogla që nuk ndryshojnë karakteristikat kryesore. Në rastin konkret, fakti që mostra është 4 litra në vend të 5 litrave nuk ndikon në performancën teknike të vajit. Meqenëse OE ka ofruar dëshmi (Certifikata dhe Deklarata e Prodhuesit dhe te operatorit ekonomik) që konfirmojnë se produkti i ofruar plotëson specifikimet e kërkuara dhe se paketimi gjatë furnizimit do të jetë sipas kërkesës së autoritetit, eliminimi mbi këtë bazë përbën një formalitet të tepruar dhe të pajustificueshëm.

Eliminimi i një OE me çmim më të lirë për një diferencë vëllimore të mostrës (1 litër dallim), kur cilësia teknike është e dëshmuar dhe konfirmimi për liferim sipas kërkesës së AK është garantuar nga OE ankues, bie ndesh me **Nenin 7 (Barazia në Trajtim/Jo diskriminimi)**. AK ka aplikuar një kriter kufizues që nuk ishte i definuar qartë në raport me madhësinë e mostrës. Po ashtu bie ndesh edhe me **Nenin 1 (Qëllimi i LPP)** përdorimi efikas i fondeve publike. Eliminimi i ofertës ekonomike më të favorshme për arsye teknike banale dëmton interesin e AK-së dhe buxhetin publik. Edhe **Rregullorja 01/2022 dhe neni 37.6** përcakton se mostra duhet të ketë etiketën me përshkrime të specifikacioneve teknike të kërkuara, pra nuk e definojnë paketimin. Meqenëse DT-ja kërkonte "një mostrë" dhe OE e ka dorëzuar atë, kërkesa administrative konsiderohet e përbushur. Karakteri i mostrës është dëshmuar për parametrat

kimiko-teknik, ndërsa paketimi është obligim kontraktual që verifikohet gjatë fazës së pranimit të mallit (ekzekutimit). AK-ja duhet të vlerësojë substancën teknike të mostrës dhe dokumentacionin përcjellës, e jo formën e paketimit të dëshmisë fizike.

Autoriteti Kontraktues ka gabuar kur e ka kualifikuar ofertën si të papërgjegjshme mbi bazën e vëllimit të mostrës. Ky veprim përbën aplikim të gabuar të Nenit 59 të LPP-së dhe shkelje të parimit të transparencës dhe trajtimit të barabartë. Eksperti Shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor i OE është **i bazuar**.

Pergjigje ne pretendimin e dyte

Operatori Ekonomik konteston eliminimin nga AK për Pozicionin 3 (AdBlue), me arsyetimin se mostra e dorëzuar mbante mbishkrimin "ISO 22241" dhe jo "ISO 22241-1" siç kërkohej. OE pretendon se ky eliminim është i padrejtë pasi dokumentacioni teknik (Katalogu dhe Certifikatat e kualitetit) vërtetojnë qartë se produkti plotëson standardin ISO 22241-1, ku ky i fundit është metodë testimi brenda standardit bazë ISO 22241. OE ka dorëzuar Autorizimin e Prodhuesit dhe Deklaratën e Konformitetit që garantojnë përmbushjen 100% të specifikave të Dosjes së Tenderit (DT). AK ka pranuar se nuk ka kërkuar sqarime sipas Nenit 59 dhe 72 të LPP-së, duke paragjykuar rezultatin, veprim ky që bie ndesh me praktikën e mirëfillta të prokurimit dhe parimin e trajtimit të barabartë.

Ekspertit shqyrtues pas analizës së dokumentacionit të tenderit dhe ofertës së OE ankues, konstaton si vijon. Standardi ISO 22241 është standardi ombrellë (i përgjithshëm) që bashkon disa nën standard specifike (1-5) të (AdBlue). Pjesa "-1" (ISO 22241-1) i referohet specifikisht kërkesave të cilësisë. Në aspektin teknik, një produkt që certifikohet sipas ISO 22241 nënkupton përmbushjen e pjesëve përbërëse të këtij standardi. Në kontekstin profesional, nëse një Operator Ekonomik thotë se produkti është **ISO 22241**, ai teknikisht ka pohuar se produkti plotëson edhe **pjesën 1** të tij, pasi nuk mund të jetë pjesë e "ombrellës" pa plotësuar kriteret bazë të cilësisë. Megjithatë, vendimtare në këtë vlerësim është se **Katalogu Teknik** i dorëzuar në ofertë specifikon qartë standardin ISO 22241-1, ne te kunderten kërkesa e DT per ofrim te katalogut nuk do te kishte kuptim.

AK nuk mund të bëjë eliminimin e një OE bazuar vetëm në një element formal të etiketës së mostrës, kur dokumentacioni teknik shoqëruar (i cili ka fuqi dëshmuese më të lartë se etiketa e mostrës) konfirmon përputhshmërinë. Sipas Nenit 59.4 të LPP-së, AK duhet të anashkalojë gabimet ose lëshimet që nuk përbëjnë devijim material. Mungesa e prapashtesës "-1" në etiketën e mostrës, ndërkohë që katalogu e posedon atë, konsiderohet gabim formal/jo-material.

Eksperti Shqyrtues vëren me shqetësim arsyetimin e AK-së se "nuk kemi kërkuar sqarim pasi nuk do të sillte rezultat". Ky konstatim është i pabazuar ligjërish. Neni 72 i LPP-së dhe Rregullorja 01/2022 obligojnë AK-në që, në rast të paqartësive midis mostrës dhe katalogut, të kërkojë sqarime zyrtare për të vërtetuar gjendjen faktike. Refuzimi i AK-së për të shfrytëzuar këtë mekanizëm ligjor përbën shkelje

të procedurës dhe diskriminim të OE-së me çmim më të ulët.

Posedimi i **Autorizimit të Prodhuesit dhe Certifikatave ISO 9001** të prodhuesit LPC Greqi, krijon siguri të mjaftueshme se produkti është industrial dhe i certifikuar. AK ka pasur dëshmi të mjaftueshme për të konfirmuar se produkti i ofruar është ai që kërkohet në Aneksin 1.

Eliminimi i OE-së për një mospërputhje nominale në etiketën e mostrës, duke injoruar specifikimet e sakta në katalog dhe duke refuzuar të kërkojë sqarim sipas Nenit 72 të LPP-së është veprim në kundërshtim me parimet e prokurimit publik. Eksperti Shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor është **i bazuar**.

Pergjigje ne pretendimin e tretë

Operatori Ekonomik (OE) "Besiana Sh.P.K." pretendon se oferta e OE të rekomanduar për kontratë "Kadiu" është e papërgjegjshme për shkak të mospërputhjes gjeografike të prodhuesve të dokumenteve për produktet e ofruar. Mospërputhja e dokumenteve është tek, Autorizimi i prodhuesit dhe certifikata ISO 9001:2015 janë lëshuar nga prodhuesi *UAB SCT Lubricants* në Lituani, ndërsa certifikatat e kualitetit dhe katalogët e produkteve (marka MANNOL) janë lëshuar nga *SCT Vertriebs GmbH* në Gjermani.

Argumenti i OE ankues është se edhe pse kompanitë janë të ndërlidhura (pjesë e të njëjtit grup), ankuesi pretendon se certifikatat e kualitetit të një kompanie në Gjermani nuk mund të shërbejnë si dëshmi për cilësinë e vajrave të prodhuara fizikisht në Lituani, andaj dëshmitë nuk i përgjigjen produktit të ofruar.

Ekspertit Shqyrtues pas analizimit të ofertës së OE të rekomanduar dhe shpjegimeve të dhëna nga Autoriteti Kontraktues (AK), vlerëson se në industrinë e lubrifikantëve është praktikë standarde që grupet e mëdha (si në këtë rast SCT Group) të kenë një qendër administrative dhe teknike (*SCT Vertriebs GmbH* – Gjermani) e cila mban licencat, specifikimet teknike dhe menaxhimin e markës (MANNOL), ndërsa prodhimi realizohet në njësi të specializuara (*UAB SCT Lubricants* – Lituani). Dokumentacioni teknik (Katalogët dhe të dhenat teknike) lëshohet në nivel grupi për të garantuar uniformitetin e produktit pavarësisht vendit të ambalazhimit.

AK ka konfirmuar se certifikata ISO 9001:2015 e lëshuar për *SCT Lubricants UAB* mbulon "prodhimin dhe paketimin e vajrave motorik dhe industrial". Ky dokument vërteton se njësi prodhuese në Lituani operon sipas standardeve ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë. Fakti që katalogët mbajnë logon e kompanisë mëmë në Gjermani nuk e zhvlerëson përmbajtjen teknike të tyre për sa kohë që produkti (p.sh. MANNOL Energy Formula) është i identifikueshëm dhe i autorizuar nga fabrika prodhuese.

OE "Kadiu" ka dorëzuar Autorizimin nga prodhuesi direkt (Lituani) i cili deklaron se do të prodhojë produktet sipas specifikave të kërkuara nga Policia e Kosovës. Kjo krijon lidhjen e domosdoshme ligjore-teknike. Meqenëse edhe ankuesi nuk e konteston faktin që këto dy kompani janë pjesë e të njëjtit grup, pretendimi se certifikatat e kualitetit nuk dëshmojnë cilësinë vetëm për shkak të adresës së zyrës qendrore në Gjermani është një interpretim tepër formal që nuk cenon substancën e ofertës.

AK ka vepruar drejtë kur ka vlerësuar se oferta është e përgjegjshme. Dokumentet e ofruara

(Autorizimi, ISO, Katalogu) plotësojnë kërkesën e DT-së në mënyrë komulative. Nuk ka asnjë paqartësi se produkti i ofruar është ai që është certifikuar.

Dokumentacioni i ofruar nga OE i rekomanduar vërteton mjaftueshëm përputhshmërinë teknike. Lidhja midis prodhuesit në Lituani dhe kompanisë në Gjermani është e dokumentuar dhe e pranueshme në praktikën e tregtisë ndërkombëtare dhe prokurimit publik për sa kohë që marka dhe specifikat teknike të produktit janë të njëjta. AK nuk ka bërë shkelje të LPP-së duke pranuar këto dëshmi si valide. Eksperti Shqyrtues vlerëson se ky pretendim ankimor është **i pabazuar**.

Pergjigje ne pretendimin e katër

Operatori Ekonomik (OE) pretendon shkelje të Nenit 65 (paragrafi 1) dhe Nenit 4 (paragrafi 1.75) të LPP-së, duke pretenduar ekzistencën e një konflikti interesi midis Autoritetit Kontraktues (AK) dhe OE të rekomanduar për kontratë ("Kadiu" sh.p.k.).

Ankuesi pohon se z. Ramadan Sylja (Shef i Flotës në PK) ka hartuar dhe nënshkruar specifikimet teknike të këtij tenderi, ndërsa djali i tij, z. Taulant Sylja, ushtron funksionin e menaxherit në kompaninë "Kadiu" sh.p.k. AK ka refuzuar ti ofrojë ankuesit qasje në dokumentet e brendshme (Kërkesa e njësisë kërkuese dhe DNPDF), të cilat do të vërtetonin rolin e z. Sylja në përgatitjen e aktivitetit. Kjo situatë cenon paanësinë e procedurës dhe sipas Nenit 65.1, OE "Kadiu" duhej të eliminohej nga pjesëmarrja.

Eksperti Shqyrtues pas analizimit të bazës ligjore dhe pretendimeve të pales ankuese jep këtë mendim. Definimi i Konfliktit të Interesit (Neni 4, pika 1.75) në prokurim publik nuk kërkon domosdoshmërisht vërtetimin e një përfitimi financiar direkt. Sipas LPP-së, mjafton që një situatë të **perceptohet** si kompromitim i paanësisë dhe pavarësisë. Lidhja familjare midis personit që përcakton "rregullat e lojës" (specifikimet teknike) dhe një drejtuesi në kompaninë që garon, përbën një rast tipik të konfliktit të interesit. Ndalimi i pjesëmarrjes sipas Nenit 65.LPP-së, thekson se një OE nuk ka të drejtë të marrë pjesë nëse një punonjës ose menaxher i tij ka qenë pjesëmarrës në përgatitjen e dosjes së tenderit. Nëse vërtetohet se z. Taulant Sylja ka pozitë menaxheriale te OE "Kadiu" dhe babai i tij ka hartuar specifikimet në PK, atëherë OE "Kadiu" automatikisht bëhet i papranueshëm për këtë aktivitet prokurimi. Refuzimi i qasjes në dokumente nga AK me arsyetimin se Kërkesa e njësisë kërkuese dhe DNPDF janë "dokumente të brendshme" është i pa justifikueshëm në raport me ankesën për konflikt interesi.

Për ta vërtetuar këtë pretendim përtej dyshimit të arsyeshëm (i cili momentalisht bazohet në rrjete sociale facebook), Eksperti Shqyrtues rekomandon AK që në procesin e rivleresimit nese nga OE ankues kerkohet ky document, ti dorëzohet menjëherë emërimi i anëtarëve të njësisë kërkuese që kanë hartuar specifikimet teknike. Të vërtetohet nëse z. Taulant Sylja figuron si i punësuar në kompaninë "Kadiu" sh.p.k. gjatë periudhës së shpalljes dhe vlerësimit të tenderit. Të shqyrtohet nëse z. Ramadan Sylja ka nënshkruar "Deklaratën nën Betim mbi Konfliktin e Interesit" gjatë fazës së përgatitjes, siç kërkohet me rregullat e brendshme të PK-së dhe LPP-së. Nëse të dhënat e prezantuara nga ankuesi vërtetohen përmes dokumenteve zyrtare pretendimi ankimor është **i bazuar**. Situata e tillë paraqet shkelje të rëndë të parimit të integritetit dhe barazisë së ofertuesve.

Mendimi perfundimtar i ekspertit shqyrtues

Mbështetur në të gjeturat e mësipërme, Eksperti Shqyrtues **aprovon pjesërisht** ankesën e Operatorit Ekonomik si të bazuar (lidhur me pretendimet 1, 2 dhe 4) dhe bazuar në Nenin

114.2 të LPP-së, rekomandon autoritetin kontraktues që anulojë njoftimin mbi vendimin e AK te dates 17.03.2026 dhe ta kthejë lëndën në **RIVLERËSIM**.

Gjatë rivlerësimit, AK-ja udhëzohet të aplikojë drejt Nenin 59 dhe 72 të LPP-së për të vërtetuar përputhshmërinë teknike dhe të sqarojë rrethanat e konfliktit të interesit para marrjes së vendimit të ri.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “**Besiana SH.P.K.**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**FURNIZIM ME VAJRA PËR AUTOMJETE TE PK-se**” me numër të prokurimit: “**214/30400-25-9404-1-1-1**”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **POLICIA E KOSOVËS**

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **POLICIA E KOSOVËS**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **Besiana SH.P.K.**

